



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 mars 2013
Nr.i Ref.:RK388/13

**VENDIM PËR KËRKESËN PËR MASË TË
PËRKOHSHME**

në

Rastin Nr. KI17/13

Parashtruesi

Bujar Bukoshi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në
Prishtinë,
Ka, Nr. 562/12 të 8 tetorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Bujar Bukoshi, ish-Ministër i Shëndetësisë, me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga Besnik R. Berisha, avokat nga Prishtina.

Vendimi kontestuar

2. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) ta shqyrtojë vendimin, Ka. Nr. 265/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të nxjerrë më 8 tetor 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 10 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit, Ka. Nr. 265/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i cili e konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi thekson se pretendimet kundër tij në aktakuzë janë antikushtetuese, pasi që veprimet dhe vendimi që ka marrë ishin brenda fushëveprimit të kompetencave të Ministrit të Shëndetësisë.
4. Parashtruesi më tutje kërkon nga Gjykata që të vendosë masa të përkohshme për suspendimin e hetimeve penale kundër tij, derisa Gjykata ta merr vendimin përfundimtar.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: "Ligji") dhe Rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Rregullorja e punës").

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 shkurt 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 13 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
8. Më 25 shkurt 2013, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI. 17/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI. 17/13, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 8 mars 2013, Gjykata Kushtetuese, përmes një shkrese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
10. Në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Apelit në Prishtinë, si pasardhëse e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Përmbledhja e fakteve sipas parashtruesit të kërkesës

11. Më 16 korrik 2012, Prokurori Special i EULEX-it e dorëzoi aktakuzën e ndryshuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, PPS Nr: 64/11, 465/09 dhe 424/09, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës akuzohej për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimeve, e dënueshme me nenin 339, paragrafët 1 dhe 3, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilën parashikohet dënimi prej 1 deri 8 vite burgim.
12. Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 3 dhe 5 shtator 2012 mbajti seanca për konfirmimin e aktakuzës. Gjatë seancës së 3 shtatorit, avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës e ngriti çështjen e imunitetit funksional gjatë mandatit të parashtruesit të kërkesës si Ministër i Shëndetësisë.
13. Më 11 shtator 2012, gjykatësi përgjegjës për konfirmimin e aktakuzës, me Vendimin Ka.No.562/12, e refuzoi kërkesën e avokatit mbrojtës për ta marrë në konsiderim mbrojtjen e ofruar nga neni 98 i Kushtetutës. Gjyqtari arsyetoi se akuza për shpërdorimin e detyrës zyrtare nuk ishte brenda fushëveprimit të përgjegjësisë si Ministër i Shëndetësisë.
14. Më 14 shtator 2012, avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë kundër vendimit të lartpërmendur në Kolegjin penal prej tre gjyqtarëve. Parashtruesi argumentoi se aktet dhe vendimet që ai mori, për të cilat ai ishte akuzuar, ishin në cilësinë e Ministrit të Shëndetësisë.
15. Më 18 shtator 2012, Kolegji i Gjykatës së Qarkut, me Vendimin Ka.Nr.562/12, e refuzoi Ankesën si të pabazuar në lidhje me imunitetin e parashtruesit të kërkesës si ish-Ministër i Shëndetësisë.
16. Më 8 tetor 2012, gjyqtari përgjegjës për konfirmimin e aktakuzës nxori Vendimin KA. Nr. 265/12, që konfirmoi aktakuzën e Prokurorit Special dhe gjykimi filloi.

Argumentet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se neni 98 dhe neni 23 të Kushtetutës janë shkelur.
18. Neni 98 [Imuniteti] i Kushtetutës parasheh se:

“Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësiave të tyre si anëtarë të Qeverisë.”

19. Në lidhje me këtë, parashtruesi pretendon se ai kishte imunitet funksional për të gjitha veprimet dhe vendimet të cilat ai i mori si Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ato ishin në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Prandaj, ai nuk mund të ndiqet penalisht.

20. Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] i Kushtetutës ofron mbrojtje të dinjitetit njerëzor të individit, duke përcaktuar se:

“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themeloretë njeriut.”

21. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se konfirmimi i aktakuzës ishte bërë publik dhe kjo e kishte dëmtuar reputacionin e tij, duke shkelur kështu dinjitetin e tij njerëzor.

Kërkesa për masë të përkohshme

22. Në këtë rast, parashtruesi kërkon nga Gjykata të vendosë masa të përkohshme për suspendimin e procedurës penale kundër tij në gjykata të rregullta, deri në gjykimin përfundimtar të kërkesës.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata merr në konsiderim se, në pajtim me rregullin 55 (1) të Rregullores, *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” dhe gjithashtu rregulli 55 (6) “[...]Rekomandimi i Kolegjit shqyrtues për aplikimin e masës së përkohshme bëhet vendim i Gjykatës, përveç; nëse një ose me shumë gjyqtarë ia paraqesin ndonjë vërejtje Sekretarit të Përgjithshëm brenda tri (3) ditësh. [...]”*.

24. Neni 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës përcakton:

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme.”

25. Neni 27 i Ligjit gjithashtu parasheh:

“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.”

26. Për më tepër, në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme sipas rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, duhet pra të vlerësojë se:

(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmerinë e saj, rastin prima facie për pranueshmerinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(..)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.”

27. Gjykata vëren se rasti është nën shqyrtim nga gjykata e rregullt, ku parashtruesi do të jetë në gjendje të ushtrojë ankesat e tij për shkeljen e pretenduar të drejtave të tij.
28. Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk është gjykatë e faktit dhe se është kompetencë e gjykatave të rregullta që në këtë fazë të mbledhin dhe vlerësojnë provat dhe të vendosin nëse veprimet dhe vendimet ishin brenda fushëveprimit të Ministrit të Shëndetësisë, i cili mbrohet me imunitet funksional dhe të gjykohet në mënyrë përkatëse.
29. Prandaj, Gjykata Kushtetuese, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata për pranueshmërinë ose meritat në të ardhmen, më 14 mars 2013, me shumicë votash

VENDOSI

- I. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme
- II. Ky Vendim do të komunikohet palëve; dhe
- III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani